



Republic of Kosovo
State Prosecutor
Republika e Kosovës
Prokurori i Shtetit

*Special Prosecution office of the Republic of Kosovo
Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
Kancelarija Specijalnog tužilaštva Republike Kosovo*

Bazuar në nenin 11, paragrafin 7 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit dhe ligjeve të tjera në fuqi;

Kryeprokurori i Shtetit Z. Ismet Kabashi, Kryeprokurorja e EULEX-it Znj. Jaroslava Novotna dhe Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Z. Jonathan Ratel, u pajtuan për të lëshuar sic vijon:

UDHËZIM

Neni 1- Një vepër e korrupsionit do të konsiderohet si e nivelit të lartë, kur i dyshuari është i dyshuar për kryerjen e një vepre penale sic vijon:

- a. Lidhja e kontratave të dëmshme, rënduar nga ryshfeti (neni 291(2))
- b. Dhënia e paarsyeshme e dhuratave (neni 316)
- c. Arratisja e personave të privuar nga liria, rënduar nga ryshfeti (neni 405(2))
- d. Mundësimi i arratisjes së personave të privuar nga liria, rënduar nga ryshfeti (neni 406(2))

- e. Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (neni 422)
- f. Përvetësimi në detyrë (neni 425)
- g. Mashtrimi në detyrë (neni 426)
- h. Përdorimi i paautorizuar i pasurisë (neni 427)
- i. Marrja e ryshfetit (neni 428)
- j. Dhënia e ryshfetit (neni 429)
- k. Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj (neni 430)
- l. Ushtrimi i ndikimit (neni 431)
- m. Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore (neni 432)
- n. Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme (Article 435)
- o. Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor (neni 436)

Dhe kur aplikohet njëra nga kushtet e specifikuar në paragrafët 2, 3 ose 4

Neni 2- Ku subjekti i dyshuar për kryerjen e kësaj vepre është:

- a) Presidenti i Kosovës;
- b) Presidenti dhe anëtarët e parlamentit të Kuvendit të Kosovës;
- c) Kryeministri, zëvendës kryeministri/at dhe ministrat e Qeverisë së Kosovës;
- d) Kryetarët e komunave
- e) Gjyqtarë të Gjykatës Supreme të Kosovës
- f) Gjyqtarë të Gjykatën e Apelit
- g) Kryeprokurori i Shtetit
- h) Kryeprokurorët

Pavarësisht nga vlera e veprës penale ose përfitimi fituar.

Neni 3- Ku subjekti i dyshuar për kryerjen e kësaj vepre është:

- a) Zëvendës ministër i Qeverisë së Kosovës;
- b) Shërbyes civil i nivelit të menaxhimit të lartë (Sekretar i Përgjithshëm apo pozita te barasvlershme);
- c) Punonjësi i ministrive dhe institucioneve publike në vendimmarrje ose pozicione këshilluese; **dhe**

Ku përfitimi nga vepra kriminale ose dëmi i shkaktuar si rezultat i një vepre të caktuar të korrupsionit tejkalon shumën prej 500.000,00 EURO;

Neni 4 - Një vepër korrupsioni do të konsiderohet si korrupsion i nivelit të lartë në çdo rast ku përfitimi nga vepra kriminale ose dëmi i shkaktuar si rezultat i një vepre të caktuar të korrupsionit e tejkalon shumën prej 1.000.000,00 EURO

Neni 5 - Në hetimet që i nënshtrohen këtij udhëzimi, procedura për të shkaktuar kompetencë plotësuese të PSRK-së do të zbatohen sic është detajuar në Nenet 9, 10 dhe 11 të Ligjit mbi PSRK-në

- a) Informacione dërguar nga prokurorët e prokurorive themelore tek Kreyprokurorët e Prokurorive Themelore përkatëse lidhur me rastet që bien në nenet e Ligjit për PSRK-në;
- b) Raporti nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore drejtuar Kryeprokurorit të PSRK-së;
- c) Propozimi nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore drejtuar Kryeprokurorit të PSRK-së për të transferuar rastin në PSRK;
- d) Vendimi i Kryeprokurorit të PSRK-së;
- e) Vendimi i Kryeprokurorit të Shtetit në rast të refuzimit të propozimit nga ana e Kryeprokurorit të PSRK-së

Neni 6 – Ky është një udhëzim i detyrueshëm për të gjitha prokuroritë e Republikës së Kosovës;

Neni 7 – Të gjitha institucionet shtetërore, të tilla si Policia e Kosovës, Agjencia Anti-Korrupsion dhe të tjerët janë të inkurajuar për të nxjerrë udhëzimet përkatëse / rregulla të brendshme të zbatueshme ligjore.

Neni 8- Ky Udhëzim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe është i aplikueshëm për të gjitha lëndet e pranuar në punë pas kësaj date.

Neni9- Miratuar me datë 13 nëntor 2013.

Kryeprokurori i Shtetit


Ismet Kabashi

Kryeprokurorja e EULEX-it


Jaroslava Novotna

Kryeprokurori i PSRK-së


Jonathan Ratel